



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:301759
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05517161

C.nr.310/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtarin Alush Sinani, me bashkëpunëtoresh profesionale Adelina Ajeti, në çështjen kontestimore të paditëses E.I., nga Komuna e V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.A., avokat në V., kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 373.83 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 18.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.I., nga Komuna e V., dhe detyrohet e paditura Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, t'ia paguajë: për periudhën Janar - Dhjetor 2021, shumën 171.76€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë (datë 26.12.2023) e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

II. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë në emër të inflacionit, e kërkuar për periudhën Janar-Dhjetor 2018, Janar - Dhjetor 2019 dhe Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 202.07€.

III. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë 96€, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit, ndërsa, paditëses i refuzohet shuma e kërkuar prej 26 € në emër të përpilimit të padisë.

Arsyetim

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 26.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 373.83 €.

Në padi, paditësja ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në ShFMU "B.H.", në V., dhe nga gjykata ka kërkuar që e paditura, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën Janar-Dhjetor 2018, t'ia paguajë shumën 55.57 €; për periudhën Janar-Dhjetor 2019, t'ia paguajë shumën 136.40 €; për periudhën Janar-Dhjetor 2020, t'ia paguajë shumën 10.10 € dhe për periudhën Janar-Dhjetor 2021, t'ia paguajë shumën 171.76 €, në shumën e përgjithshme prej 373.83 €. Të drejtën e saj e ka bazuar në nenin 35, paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t

14.04.2017 dhe 22.01.2021. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumë prej 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjithashtu, e paditura është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditëses ashtu që, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditëses si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia”.

Nga përgjigja e të paditurës në padi, gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura, se pagën bazë e ka 421 € (fakt i provuar edhe nga lista e pagës në emër të paditëses) ndërsa se shkalla e inflacionit për V.n 2020 është 0.2 % dhe për V.n 2021 është 3.4 % (fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës).

Gjykata, duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje meritorë në këtë çështje juridike kontestimore, pasi provat materiale janë lëshuar nga organi shtetëror – lista e pagave nga ministria përkatëse dhe prova lidhur me shkallën e inflacionit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Pasi e paditura e ka kontestuar bazën ligjore të kërkesëpadiës dhe është thirrur në parashkrim të kërkesës, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadiës bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021; nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e V.t 2017 aplikohen edhe për periudhën Janar 2019– 20.01.2021, ndërsa pas kësaj date ato të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022.

Numri i lëndës:

2023:301759

Datë:

28.03.2024

Numri i dokumentit:

05517161

Gjykata, pasi gjeti se paditësja e cila është e punësuar tek e paditura nuk është kompensuar për shkallën e inflacionit sipas përqindjes së përcaktuar nga Enti i Statistikave të Kosovës, ndërsa ky kompensim arrin shumat e aprovuara, të cilat janë të llogaritura në bazë të përqindjes për V.n përkatës dhe periudhës kohore të kërkuar për këto vite, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit pasi që kërkesa për pagimin e shumës së kërkuar për periudhën Janar-Dhjetor 2018, Janar-Dhjetor 2019 dhe Janar-Dhjetor 2020 është parashkuar, kjo sepse paditësja ka ushtruar padi me datë 26.12.2023 dhe kështu ka kaluar afatin tre vjeçar brenda së cilës ka pasur të drejtë të realizojë kërkesën e saj përkatësisht, kërkesa për periudhën Janar-Dhjetor 2018, Janar-Dhjetor 2019 dhe Janar-Dhjetor 2020, ka qenë e arritshme vetëm deri në Dhjetor të V.t 2020 edhe atë, duke u mbështetur në nenin 87 të Ligjit të Punës është paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” andaj, gjykata aprovoi të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimeve se nuk ka pasë inflacion të theksuar, sipas nenit 35 të Kontratës mjafton vetëm konstatimi se ka pasur inflacion.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

E paditura u detyrua t'i bartë shpenzimet e procedurës si në pikën II të aktgjykimit, duke u mbështetur në nenin 452.3 dhe 453.2 të LPK-së, meqë kërkesëpadia është në të holla dhe shpenzimet u caktuan sipas lartësisë së kërkesës së pranuar me aktgjykim, e që i referohen përpilimit të padisë në shumën prej 78€ sipas Rregullores për Tarifa të OAK, dhe taksës së paguar gjyqësore në shumë 20€. Për këto arsye, paditësit iu refuzua shuma 26 Euro, e kërkuar në emër të përpilimit të padisë nga avokati. Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.310/2024, Datë 18.03.2024

Gjyqtari,
Alush Sinani

Numri i lëndës:

2023:301759

Datë:

28.03.2024

Numri i dokumentit:

05517161

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.